



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 146/14
Prishtinë, më 12.03.2014, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Muhamet Musafa, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziraj, Sevdije Lama, dhe Duda Balje.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini dhe Dashurije Canolli.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Safet Hoxha- Kryesues i KRPP-së, Ramadan Islami nga GIZ, Qendresa Mensuri-KDI, Isuf Zena-KDI, Pranvera Musa -Kosova Sot, Visar Prenaj- Koha Ditore.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj Kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 05.03.2014;
3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2013;
4. Shqyrtimi i raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik për vitin 2013;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-127 për regjistrimin e bujqësisë me amendamentet e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;
6. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-61 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore me amendamentet e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;
7. Të ndryshme.

Naser Osmani: njoftoi se grupi punues i Komisionit, ka përfunduar punën në hartimin e Projektligjit për Lojërat e Fatit. E kam të qartë se është një procedurë të përsheptuar, por meqë jemi në presion të kohës në procedimin e këtij projektligji, propozojë që kjo qështje radhitet për shqyrtim në mbledhjen e sotme të komisionit.

Albana Fetoshi: theksoj se ne e kemi bërë monitorimin e ligjit për lojërat e fatit dhe nëse janë marrë parasysh rekomandimet që janë votuar në Kuvend, në këtë draft të ri të hartuar nga grupi punues, jam për të futur në rendin e ditës për shqyrtim këtë projektligj.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja: konstatoi se rendi i ditës miratohet me plotësimin e një pikë shtesë - pika e shtatë me radhë: Shqyrtimi i Propozim-Projektligjit për Lojërat e Fatit, të hartuar nga Grupi Punues i Komisionit për Buxhet dhe Financa.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 05.03.2014

Muhamet Mustafa: theksojë se rekomandimi i KBF lidhur me kandidatët e propozuar nga Paneli i seleksionues për përzgjedhjen e një antëtari joekzekutiv të bordit të BQK-së, në arsyetim nuk po shoh se është shënuar asgjë prej asaj që e kemi diskutuar këtu.

Latif Gashi: lidhur me qështjen që ngriti parafolesi, theksoi se disa kanë qenë të pakënaqur, po në komision kemi vlerësuar se kandidatët përmbushin kushtet ligjore dhe nuk kemi marrë vendim që të përfshijmë vërejtjet e të paknaqurëve, ato mund të ngriten në senacë.

Naser Osmani: sqaroi se ne kemi ardhur në përfundim me i rekomandue Kuvendit emrat e propozuar dhe gjatë fjalës tonë, që duhet ta prezantojmë në Parlament, jemi dakordue që ti japim vërejtjet, për arsye se CV-të e tyre nuk kanë qenë shumë domethënëse apo të pëlqyshme për pozitën e propozuar. Selektimin dhe intervistimin e ka bërë paneli i BQK-së, dhe kemi pas vështirë me e dhënë një mendim pozitiv. Por roli i komisionit tonë është nga aspekti ligjorë me i shikue nëse kandidatët përmbushin kushtet formalo juridike, kryetarja apo kushdo tjetër që e paraqet në kuvend arsyetimin e rekomandimit, do ti paraqes këto vërejtje.

Kryetarja: konstatoi se miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar të komisionit.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2013

Kryetarja: siç është e paraparë me ligjin për prokurimin publikë, KRPP ka paraqitur në Kuvend raportin vjetor të punës dhe raportin financiar. Raporti përmban shënimet e kërkuara me ligj dhe kemi mundësi të shofim shumë të dhëna rreth prokurimit publik. Gjatë viti 2013 janë prezantuar kontratat e nënshkruara nga autoritetet kontraktuese, ku ndër të tjera përfshihet edhe kontrata e autostradës Morinë-Merdatë që përfshin dikun 12,72% të vlerës së bruto produktit vendor . Shofim se kontratat me procedurë të hapur janë ardhur duke u rritur nga viti në vit. Gjatë vitit 2013 kanë vazhduar trajnimet, si dhe janë bërë monitrimet e autoriteteve kontraktuese, siç e kërkon ligji. Sa i përket raportit financiar, shofim se buxhetin ky institucion e ka shpenzuar 93.78%.

Safet Hoxha: sqaroi se raporti është i ndarë në dy pjesë, pjesa e parë i referohet punës së autoriteteve kontraktuese ne nivel të kosovës, pjesa e dytë ka të bëjë me punën dhe aktivitetet e KRPP-së. Në pjesën e parë të raportit shofim se 12,551 kontrata janë nënshkruara gjatë vitit të kaluar, prej tyre i kemi ndarë kontratat që janë të nënshkruar nga autoritetet qeveritare 9,682, kompanitë publike 2,880, OJQ-të 30. Në aspektin monetar i gjithë ky aspekt i prokurimit kap shumën mbi 444,131,399,10 milion euro. Nëse vlerës së prokurimit ia shtojmë edhe autostradën, del që 508,600,000 milion euro janë prokuruar dhe kanë qenë aktivitete financiare që janë zhvilluar nga qeveria. Nga të hyrat vetanake

kanë qenë 93 milion euro që janë realizuar përmes prokurimit publik, ndërsa donacionet kanë mbajtur vlerën e njëjtë nga viti 2011 deri 2013. Sipas llojit të prokurimit kemi një indikator shumë të mirë, e në këtë vit vlera e furnizimeve është 138,000,000 milion euro, shërbimet janë 45 milion euro, ndërsa punë 259,000 euro, dhe është jashtëzakonisht e mirë për institucionet kontraktuese që i kanë ulur furnizimet dhe investimet i kanë orientuar në punë. Gjithashtu te ndarja e këtyre kërkesave në këtë vit nëse e fusim në punë edhe autostradën del se 470,000,000 milion euro ne kemi bërë punë. Një indikator tjetër është se sipas vlerës së prokurimit prapë kemi vlera të mëdha dhe të mesme, e parametrave të njëjtë me vitet e kaluara, e vlera e vogël është ulur pak, ndërkaq vlerat minimale janë në nivelin e njëjtë. Për këtë vit procedurat e hapur të vlerave të kontratave është 390 milion euro, pa përfshirë autostradën. Procedurë e negociuar pas publikimit është 75,000 euro, ndërsa procedurë e negociuar papublikim është 24 milion euro. Te organizatat, procedurat e hapura janë në vlerë prej 88.67%, procedurë e negociuar papublikim 4.44%. Te kompanitë publike kemi një përdorim më të madh të procedurave të hapura edhe ajo lidhet kryesisht me KEK-un. Edhe OJQ-të kanë vlerën më të lartë të procedurave të hapura prej 98%. Sa i përket vlerave të aneksë kontrata, janë nënshkruar 1.23 %, ndërsa ligji lejon deri në 10 % të vlerës së kontratave me u përdorë. Një indikator tjetër pozitiv është ndarja e kontratave për operatorë vendor dhe jo vendor. Vlera e kontratave të nënshkruara sipas afatit kohor për publikim, në afate normale janë publikuar 92% të tenderëve, e në afate të shkurta kohore janë 56% të aktivitetëve. Sipas vlerave të kontratave, sipas kriterit qmimi më i ulët 98% e të aktivitetëve 2% çmimi ekonomikisht i favorshëm. Numri i ofertuesve që kanë konkuruar për një tenderë gjat vitit 2013 mbetet 5.2 duke futur edhe tenderët që janë pa prokurim. 167 autoritete kontraktuese i kanë dorëzuar të dhënat vjetore të aktivitetëve të prokurimit, disa autoritete nuk kanë arritur ti dorëzojnë të dhënat dhe një numër autoritetesh janë liruar, siç është kompania rajonale e mbeturinave që ka kaluar në partneritet publik privat në rajonin e Gjilanit, dy OJQ nuk kanë pas aktivitete të prokurimit, gjithashtu qendra regjionale për mjedisin në evropën qendrore dhe lindore kanë deklaruar që nuk kanë pasur aktivitete të prokurimit. Komisioni ka nevojë të shtojë kapacitetet e tija në kryerjen e aktivitetëve të shumta, të kemi ekspertë që do të ndihmonin në procesin e monitorimit të performancës dhe krijimin e databazës për një indeks të çmimeve.

Hykmete Bajrami: falenderojë kryesuesin e KRPP-së për një prezantim të detajuar, por kam një vërejtje sepse kur bëhet prezantimi normalisht se është aftësi e njerëzve që përfaqsojnë institucionet dhe që mbrojnë të tjerat që të dalin me shifra dhe që të paraqesin një pasqyrë të mirë. Por gjithmonë kur flitet në raport me kontratat që ju kanë dhënë operatorëve vendorë edhe operatorve publik, kur kemi të bëjmë me periudhën kur është përfshirë autostrada, do të duhej të përfshihej edhe shuma për autostradën, sepse në vitin 2013 kur është dhënë ky proporcion në mes operatorëve vendor dhe atyre të jashtëm, besojë se nuk është bërë një prezantim i saktë, për arsye se janë 200 milion euro që ia dhënë Bektel Enkës dhe duhet të reflektohet në raport. Kontrata për autostradën është nënshkruar në vitin 2010 dhe në këtë drejtim pyes se si e keni paraqit në këtë raport, ne mes të fituesve të tenderëve si operator vendor dhe atyre të huaj në vitin 2010, a ka figure një kontratë e nënshkruar prej 1 miliard eurove e fitime nga një operator i jashtëm. Nuk dëgjuam asgjë për sfidat e prokurimit, që e dimë se është shumë problematike, unë kisha dashur të dëgjoj nga ju se sa ka qenë sfida për autoritetet kontraktuese mos funksionimi i organit shlyrtues të prokurimit. E dim që kemi një numër të madh të kontratave të cilat janë të ngelura pezullë, sa ka paraqit sfida kjo edhe sa ka ndiku kjo që kontrata e nënshkruara të mos të realizohen. Keni përmendur numrin e shkeljeve prej mbikëqyrjeve që keni bërë dhe ka shumë shkelje, thatë që nga 300 monitorime, 244 kanë qenë vetëm shkelje procedurale, 63 kanë qenë shkelje në menaxhim të kontratave, është mirë që të paraqiten cilat janë masat ndëshkuese që janë marrë. Nuk mjafton vetëm të eidentohen shkeljet, por është mirë që personat që bëjnë shkelje procedurale apo të tjera, të tregohen sa është numri i atyre personave, sepse vetëm nëse ndëshkohen personat e që bëjnë shkelje, ka mundësi të evitojmë shkeljet në të ardhmen.

Muhamet Mustafa: thekson se sa i përket buxhetit po shifet se ka pas kujdes dhe rregullësi, e nuk kemi shumë probleme. Ne mund të jemi të kënaqur për punën e bordit dhe aktivitetet që ka ndërmarrë, por të gjithë e dijmë se situata në prokurimin publik është shumë problematike, përceptimet për të janë shumë të këqija në përgjithësi, që nuk ka lidhje vetëm me këtë organ. Megjithatë ne presim prej të këtij organi të shofim se ku janë problemet kryesore dhe çka po e pengon zhvillimin e procesit të prokurimit publik në një nivel më të lartë që paraja publike të shpenzohet me interesin më të mirë publik. Unë e çmojë shumë departmanetin e rregullave që po shofim se ka pasur aktivitete, por për mua esenciale është aktiviteti i monitorimit të rregullsisë dhe monitorimit të performancës. Unë mendoj se i keni rrit aktivitetet në këtë fushë nëse e krahasojmë me vitin e kaluar, por ende kjo nuk është e domosdoshme, sepse problemet më të mëdha në prokurimin publik janë në zbatimin e kontratave. Dhënia e kontratës me çmimin me të ulët, specifikimet në këtë kriter po ndikojnë në deformimin e procesit në praktikë apo zbatim. Për të përmirësuar gjendjen këtu, si organ duhet të rriten kapacitetet në monitorim.

Hasime Krasniqi: të dhënat e ofruara në këtë raport janë të detajuara, si ato për punën që ka bërë ky komision, po ashtu edhe për raportin financiar. Sa i përket vlerave të kontratave në pjesmarjen e prokurimit publik sipas procedurave të prokurimit, shofim një ngritje të vazhdueshme për çdo ditë për procedurë të hapur ku kanë shkuar 87.86%, krahasuar më vitin 2012 prej 84%. Mandej në procedurë në vlerën minimale është 0.57 %, proceduarë e negociuarë pa publikim të njoftimit të kontratës po ashtu kemi një ulje për qind për qind krahasuar me vitin 2012 që ishte 10.48%. Kuotimi i çmimeve po ashtu kemi një rënie. Procedurë e negociuar pas publikimit të njoftimit të kontratës, krahasuar me vitin 2012 ku ka qenë 0.10%, në vitin 2013 ka ardhur një zvogëlim deri 0,02%, që unë mendoj se është një rezultat i punës së që e bërë ky komision, duke vazhduar me konkursin për projektme nga 0.24 % në 2012, me 0.17% për 2013. Pjesëmarrja në vlerën e kontratave të nënshkruar gjatë vitit 2012 sipas organizatave buxhetore qeveritare prej 86.68%, në vitin 2013 ka arritur procedurën e hapur në 88.67%. Te kompanitë publike po ashtu kemi një ngritje të përqindjes së procedurës së hapur të prokurimit me 84,64% për 2013 krahasuar me 79 % sa ka qenë në 2012. Gjithashtu kemi një rritje simbolike të procedurës së hapur te OJQ-të me 98.60% krahasuar me 98% në vitin 2012. Sa i përket raportit financiarë kisha një pyetje se kemi një tajkalim të shpenzimeve të disa nënkategori krahasuar me planifikimin, kemi kategori që është shpenzuar më tepër apo nuk ka qenë e planifikuar dhe janë bërë shpenzime. Shofim se te shpenzimet për shërbime, konkretisht te trajnimet janë tejkaluar shpenzimet, si dhe për disa nënkategori tjera, që është e nevojshme të jepet një arsyeshmëri. Përndryshe e vlerësojë punën në menaxhimin financiar të buxhetit nga ky komision.

Safet Hoxha: sqaroi se raporti ju referohet të dhënave që ne i marrim nga autoritete kontraktuese, mbi këtë bazë për saktësin e prezantimeve e marrin përsipër ato autoritete. Sa i përket autostrades, qështja e raportit të burimeve vendore apo atyre nderkomëtare, në 2010 nuk e di a është raportuar sepse nuk kam qenë në këtë pozitë kur është përgadit ky raport. Por prej viti 2011 gjitha raportet ne i kemi ndarë jo vetëm si shifër por secilin vit numrin e pagesave, në secilin raport e kemi pas shumë prej 654 milion euro që ka qenë vlera e nënshkrime. Edhe vlerat e paguara nga ministria e transportit, siç na kanë dërguar ne i kemi prezentu në raport. Unë mendoj se ne e kemi arrit me e sfidue prokurimin publik dhe po besoj që për të gjithë janë të njoftura sfidat në të cilat është prokurimi publik. Prokurimi publik po e paguan faturën e të gjitha proceseve që varen prej akterëve tjerë, edhe atyre politik, siç është rasti i inicimit të prokurimit publik që është një vendim politik. Ne mundemi me e pas një aktivitet shumë të mirë të prokurimit por me e fitu një kontratë të mirë e të rregulltë, e oferten më të mirë me e zhgjedhë, por se procesi mundet me deformue në realizim dhe prap ne e krijojm një imazh të keq për prokurimin publik. Qështja tjetër për kuptimin e imazhit nuk mundemi me e ndryshu gjendjen në prokurim publik me ashtuquajten vetdije ligjore ne duhet të synojmë se përmes arsimimit të pjesëmarrësve në prokurim, përmes trajnimit tyre ta ngrisim nivelinë

tonë. Sa i përket aktiviteteve të monitorimit, ne kemi shtuar aktivitetet dhe kemi bërë shumë monitorime për institucione të ndryshme, përfshirë edhe ato të gjyqësisë dhe sigurisë, dhe për shkak që mos të dëmtohet hetimi disa nuk i kemi paraqitur në raport.

Muhamet Mustafa: sa monitorime i keni bërë në KEK?

Safet Hoxha: njoftoi se janë bërë dy dy monitorime me kërkesë. Sa i përket shkeljeve të evidentume në momentin që bëhet raporti i dërzohet autoritetit kontraktues, ta plotësoj me komentet e veta dhe pas një jave integrohen komentet dhe ai merr formën përfundimtare edhe një kopje i kthethet autoritetit një kopje publikohet në web faqen e KRPP-së. Ne nuk jemi të autorizuar me marrë masa sepse nuk na ka lejuar ligji. Është e nevojshme të funksionalizohet bordi i OSHP-së sepse është një organ i cili ndikon në mbarrvajtjen e prokurimit publik. Nëse duam me vu rregull definitivisht ne i kemi kapacitetet minimale me i mbulu këto aktivitete. Unë personalisht e kisha ngrit qështjen e pagave të bordit që paguhemi më së liri në Kosovë, krahasur me bordet e agjencioneve tjera.

Kryetarja: si komision po kemi problem me i plotësue të gjitha kërkesat e institucioneve të pavarura që po janë të shumta dhe kjo po krijon problem që tek një numër institucionesh të cilat vërtetë ka nevojë për ti shtuar mjetet dhe ngritjen e kapaciteteve. Megjithatë ju e dini se në vitin 2014 e keni një buxhet pak më të rritur, krahasua me vitin 2013, dhe në këtë vit ju këshillojmë që këto mjete ti orinetoni në këto dy qështje të cilat ju i keni ngrit si sfida. Sa i përket raportit financiar, kisha kërkuar me e ndryshu diqka tek tabela “pjesa e të hyrave”, ku duhet të prezantohen të hyrat që realizon institucioni dhe ju ka përvjedh një gabim i keni paraqit të hyrat nga buxheti që janë akorduar për këtë komision.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2013.

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik për vitin 2013

Kryetarja: theksoi se ne e kemi marrë raportin nga organi shqyrtues i prokurimi ku janë të pasqyruara të dhënat rreth punës së këtij organi. Në mungesë të bordit, raporti është nënshkruar nga kryesuesi i sekretariatit të OSHP-së. Me shkresë të nënshkruar nga sekretari i Kuvendit, komisioni për buxhet e financa, si komision funksional është ngarkuar ta shyrtojë këtë raport dhe kuvendit t’ia paraqes raportin me rekomandime. Raporti i përfshinë të gjitha ato të dhënat që i ka përfshinë një raport, si ka shkuar rrjedhja e ankesave dhe në mungesë të bordit shifet se kanë mbetë edhe 215 ankesa të pashqyrtuara. Unë mendoj se në mungesë të bordit për të nënshkruar dhe prezantuar raportin dhe ofruar sqarimet e nevojshme, ne si komision ta dërgojmë raportin për shqyrtim në seancë plenare dhe Kuvendi të shqyrtojë dhe vendos për raportin.

Muhamet Mustafa: thekson se ne e kemi një situatë që atje nuk ka një bord dhe raporti nuk mundet me e pasë një fuqi dokumenti që mundet me u aprovu në Kuvend. Rekomandimi im është pjesa financiare e këtij raporti të aprovohet, ndërsa pjesa tjetër të merret në dijeni që nuk është aprovue, në mungesë të bordit.

Naser Osmani: thekson se me ligj ky organ është i obliguar me i raportue Kuvendit dhe nuk është e sqaruar qfarë ndodhë në mungesë të bordit dhe tash është qështje e komisionit si vendos me trajtue. Kuvendi mundet me marrë një vendim me e shty më tutje shqyrtimin e këtij raporti, deri në kompletimin e bordit të ri.

Latif Gashi: thekson se ne mundemi me e shtye raportin, por unë mendojë se ky raport është përgadit nga ekspertët të cilët i ka ky organ, dhe po të ishte bordi i kompletuar prapë i njëjti raport do të vinte. Por megjithatë ne si komision për buxhet e financa kisha thënë ta rekomandojmë dhe seanca le të vendosë.

Xhevdet Neziraj: theksoi se është shumë problem që të trajtojmë këtë raport në mungesë të bordit i cili duhet të prezantojë dhe arsyetojë raportin në komision dhe të jap sqarimet e nevojshme në rastë se nëse kemi nevojë për informacione shtesë.

Kryetarja: njoftoi se jam përpjekë edhe paraprakisht pa hyrë në mbledhje të konsultohemi me stafin e administratës në interpretim të legjislacionit se si shkonë rrjedhja, sepse jemi ngarku me e shqyrtue këtë raport. Propozojë që si komision të rekomandojmë që raporti të shqyrtohet në seancë plenare dhe ne do të japim sqarime dhe Kuvendi të merr vendim.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të shqyrtohet Raporti vjetor i Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2013.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-127 për regjistrimin e bujqësisë me amendamentet e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Kryetarja: thekson se projektligji dhe amendamente nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxorri këtë

Rekomandim

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-127 për regjistrimin e bujqësisë, dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-61 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore me amendamentet e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Kryetarja: thekson se projektligji dhe amendamente nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxorri këtë

Rekomandim

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-61 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

7. Shyqrtimi i Projektligji për Lojërat e Fatit, të porpozuar nga Grupi Punues i Komisionit për Buxhet dhe Financa

Naser Osmani: njoftoi se propozimet për plotësimin edhe ndryshimin e ligjit janë rezultat i monitorimit të zbatueshmërisë së ligjit që ka bërë komisioni dhe rekomandimit të Kuvendit të datës të 5 dhjetor 2013 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit dhe ndalimin e lojërave të fatit në automate edhe bastore. Grupi Punues ka punuar në ndryshimin dhe plotësimin e ligjit, që në fakt është propozuar projektligj i ri për shkak të ndryshimeve të shumta që janë propozuar. Komisioni ka angazhuar dy ekspertë, njëri i financuar me buxhet të komisionit dhe tjetri është paguar nga GIZ. Sa i përket përmbajtjes së projektligjit, te përkufizimet e kemi rregulluar terminologjinë duke përshtatur me ndryshimet e reja. Te neni 4 janë përcaktuar lojërat e fatit që ndalohen me këtë ligj, e që në fakt ndalohen të gjitha lojërat që janë organizuar deri më tani, me përjashtim të lojërave që organizon lotaria e kosovës. Në rast të ushtrimit të veprimtarisë ilegale, janë paraparë denimet me gjobë dhe me burg që do të trajtohen në pajtim me kodin penal të Kosovës. Sa i përket lotarisë së kosovës, ne këtë e kemi modifikuar dhe e kemi definuar se kjo do të jetë një ndërmarrje publike, e themeluar nga qeveria e cila do të ketë kompetencat dhe përgjegjësitë e saja, e kemi ridizajnuar shpërndarjen e fitimive që realizon ajo dhe përveç atyre që kanë qenë, një pjesë do të shkojë për studenta e një për sport. Ajo që është më delikate është të dispozitat kalimtare, ne e kemi rregulluar që licencat që ka lëshuar administrata tatimore dhe që janë në fuqi, ato biznese vazhdojnë të ekzistojnë deri më 31 dhjetor 2014 nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Nëse ka operatorë që kanë marrë licencë edhe më gjatë se 31 dhjetori 2014, këtij operatori i kthehen mjetet në proporcion me kohën e pashpenzuar. Ligji i ri do të hyjë në fuqi 15 ditë pas publikimit në gazetën zyrtare dhe administrata tatimore nuk mundet me e lëshu asnjë licencë pas kësaj kohe dhe ato që janë do ta kenë validitetin deri me 31 dhjetor 2014. Mbi 400 lojëra të fatit kanë funksionuar jashtë ligjit dhe administrata tatimore nuk ka pas kapacitet me udhëheq këtë veprimtari, prandaj kjo është më se domosdoshme. Nga ana tjetër kemi thënë fuqimisht që duhet ruajtur familjen tradicionale shqiptare pasi që këto lojëra po ndikojnë negativisht në shkatërrimin e familjes. Kemi marrë të dhëna nga policia e kosovës për vepra penale që ndërliken me lojërat e fatit, për dy vite janë 127 raste që kanë të bëjnë me vrasje, tetim vrasje vetvrasje, dhunë familjare, rrëmbime etj.

Kryetarja: meqë e pranuan materialin tani dhe nuk kemi pasur mundësi ta lexojmë, janë të nevojshme të jepen disa qartësime në projektligj. Unë pajtohem të ndalet kjo veprimtari, por duhet të kihet parasysh fakti se kjo mund të ketë edhe efekte negative dhe këto veprimtari mund të ushtrohen në formë ilegale, që do të ndikonte edhe në shtimin e informalitetit. Ndoshta është mirë me e diskutuar edhe problemin e padive të mundshme, që mund të bëjnë ata të cilat kanë licencë, a është më mirë me u precizuar në ligj se si bëhet procesimi sepse ata mund të kenë afat edhe pas 31 dhjetorit të vitit 2014, e dijmë se në gjykata zhgjasin shumë proceset dhe mos ti dëmtojmë ata që kanë licencë.

Naser Osmani: ne kemi për obligim me e ba ligjin e mirë dhe organet tjera duhet të merren me zbatueshmërinë e ligjit. Neni 23 i përshkruan mënyrat e dënueshme për veprimtari ilegale. Qështja e ndërprejes së licencave është rregulluar me nenin 25.

Latif Gashi: shihet se grupi punues ka bërë një punë të mirë dhe nxjerra e këtij ligji arrin një sukses të madhë në qoftë se kemi institucione që e zbatojnë. Shqetësimi është nga gjendja të cilën e kemi me aprovimin e këtij ligji mos po kalon kjo dukuri në informalitet. Problemi është se ka shumë licenca

të cilat janë të lëshuara dhe ka me pas me qindra procese gjyqsore dhe nuk di sa ka efekt që me e nxjerrjen e një ligj të merret licenca që është lejue dhe lëshue në bazë të ligjit në fuqi. Pronarëve nuk mundemi me ja ndalu të drejtën me shkue në gjykatë me u ankue. Në parim e përkrahu këtë projektligj, por nuk e di sa do të jetë i zbatueshëm. Te neni 6 paragrafi 5 që fletë për lotarinë e kosovës, pse edhe lotaria të mos kërkohet të marrë leje prej ATK-së?

Naser Osmani: sqaroi se lotaria e kosovës është ndërmarrje publike e themeluar prej qeverisë, e nuk mundet ATK-ja me lëshu licencë. Mirëpo në kuadër të ATK-së është i themeluar departamenti që mbikëqyrë punën e saj, pasi krijon qarkullim financiar dhe gjeneron të hyra.

Muhamet Mustafa: mendoj se propozim ligji i ri është ardhur ashtu siç kemi kërkuar dhe është në harmoni me rekomandimet e Kuvendit. Unë i kuptoj shqetsimet se mund të rritet informaliteti, por kështu siç është situata vërtetë është kautike dhe duhet të bëjmë përpjekje që do të lirohemi prej kësaj situatë.

Sevdije Lama: sa i përket efekteve buxhetore në rast se mbyllen lojërat e fatit, janë dikun depozitat në shumë prej 5,919,000 milion euro dhe në rast se ndërprehen licencat, ato mjete do të mund të investohen në biznese tjera. Mjetet nga aktivitetet investive dhe personat që kanë luajtur në lojërat e fatit, do të shpenzohen në konsum.

Xhevdet Neziraj: theksoi se është ligji i parë që e kemi monitoru dhe ka pasur efekt në institucionet zbatuese, po kam pyetje prej gazetarëve se sa është kostoja buxhetore në rast se mbyllën këto lojëra. Ne po e shofim se nga mbyllja e 400 lojërave të tilla të fatit, më shumë kanë bërë dëm se sa që kanë krijuar të hyra.

Naser Osmani: thekson se kostoja buxhetore e këtij ligji është zero, sepse administrate tatimore e ka departamentin e mbikëqyrjes së lojërave të fatit, pyejta është sa është dëmi nëse vazhdon ligji i vjetër. Nuk është qështje e jonë, por e ministrisë së finacave me ba koston dhe efkete buxhetore. Nëse kanë funksionuar 400 lojëra të fatit ilegalisht, kisha dashtë me ditë sa është dëmtu buxheti i kosovës, prandaj kjo është shifër që mundet me u prodikue, sepse as mnistria e financave nuk e dinë saktë.

Hasime Krasniqi: i mbështes të gjithë diskutimet sepse të gjithë antarët e komisionit kemi pasur një qëllim të përbashkët të monitorimit të këtij ligji. Mendoj se rekomandimet që janë miratuar nga Kuvendi kanë qenë bazë e punës tonë si komision funksional. E kemi vendos interesin qytetarë para interest financiar. Ne e kemi mundësin që të gjitha mangësitë që mund të vërjemë dhe gjërat që nuk i kemi të kjarta, do të kemi hapsirë që ti plotësojmë gjatë amendamentimit në komision.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Vendim

Miratohet Propozim-Projektligji për Lojërat e Fatit, i hartuar nga Grupi Punues i Komisionit për Buxhet dhe Financa. Projektligji në pajtim me Rregulloren e Kuvendit përmes Kryesisë së Kuvendit, i dërgohet Qeverisë për mendim.

8. Të ndryshme

8.1.Kryetarja: njoftoi se dy komisionet tjera të përhershme (komisioni për integritet evropiane dhe komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim), kanë shqyrtuar Projektligjin për

ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës dhe amendamentet e propozuara nga komisioni funksional për buxhet dhe financa dhe i kanë dërguar raportet me rekomandime komisionit funksional, ndërkaq komisioni për legjislacion nuk ka dërguar raportin me rekomandime në afatin ligjor të paraparë me rregulloren e Kuvendit.

Komisioni vendosi që Raportin final me rekomandime për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, të procedojë për shqyrtim dhe miratim të dytë në seancë plenare.

8.2. Kryetarja: theksoi se Komisioni për Buxhet dhe Financa, më herët ka dërguar një kërkesë tek ministria e financave që të caktoj një person konkatues që të jetë prezent në mbledhjet e komisionit, kur shqyrtohen qështjet që vijnë nga ministria e financave apo kërkohet ndihma e ministrisë, po nuk kemi pas kthim të përgjigjes por as caktimin e personit. Propozojë që komisioni të përserisë kërkesën për ministrinë e financave dhe të kërkohet që personi të caktohet brenda dy javësh.

Komisioni njëzëri vendosi që ti drejtohet me shkresë Ministrit të Financave dhe të kërkojë që brenda dy javësh të caktojë/delegojë një person kontaktues nga kjo ministri me komisionin për buxhet dhe financa dhe të merr pjesë në mbledhjet e komisionit, kur kërkohet prezenca e tij.

Mbledhja përfundoi në orën 12:54

Përqatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj